VENDIM
Nr.794, datë 19.12.2005

PËR KRIJIMN E TASK FORCËS ANTIKORRUPSION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Task Forcës Antikorrupsion, i cili të kryesohet nga Kryeministri dhe të ketë në përbërje:

- Zëvendëskryeministrin	zëvendëskryetar;
- Ministrin e Financave	anëtar;
- Ministrin e Brendshëm	anëtar;
- Ministrin e Drejtësisë	anëtar;
- Ministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	anëtar;
- Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	anëtar;
- Drejtorin e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm dhe Antikoorrupsionit, në Kryeministri	anëtar;
- Drejtorin e Agjencisë së Prokurimit Publik	anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave	anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave	anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	anëtar;
- Kryeregjistruesin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	anëtar;
- Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme	anëtar;
- Drejtorin e Përgjithshëm të KESH-it	anëtar.

2.Task Forca Antikorrupsion ka këto funksione:

a) Analizon problemet e korrupsionit dhe të etikës së qeverisjes;

b) Përcakton përparësitë strategjike, synimet, objektivat dhe masat konkrete për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin;

c) Propozon krijimin e grupeve të punës me ekspertë, sipas përparësive, propozon detyrat e tyre për zhvillimin e veprimtarive sektoriale, si dhe monitoron punën e tyre;

ç) Miraton projektin e planit të veprimit antikorrupsion dhe të mirëqeverisjes dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave;

d) Përcakton fushat parësore për kontrollin e brendshëm, administrativ dhe financiar dhe, sipas rastit, mund të përcaktojë detyra konkrete kontrolli;

dh) Siguron bashkëpunimin ndërinstituconal për luftën kundër korrupsionit dhe zbatimin e programeve të mirëqeverisjes;

e) Siguron bashkëpunimin me komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile;

ë) Garanton transparencë në luftën kundër korrupsionit.

3. Task Forca mblidhet një herë në dy muaj ose në çdo kohë me kërkesë të kryetarit.

4. Roli dhe përgjegjësitë e çdo anëtari të Task Forcës janë:

a) të shkëmbejë informacione për çështjet e korrupsionit dhe veprimtaritë antikorrupsion në institucionin e vet;

b) të drejtojë, sipas rastit, grupet e punës sektoriale dhe të raportojë në emër të tyre;

c) të bashkërendojë të gjitha veprimtaritë e fushës që mbulojnë, si dhe të drejtojë punën për hartimin e planit të veprimeve, sipas fushës së veprimtarisë;

ç) të raportojë për zbatimin e detyrave të ngarkuara.

5. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore që:

a) të marrin masat në zbatim të detyrave të ngarkuara nga Task Forca;

b) të bashkëpunojë me grupet e punës për hartimin e planit të veprimeve sipas fushës së veprimtarisë;

c) të raportojnë pranë Task Forcës dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri, për zbatimin e planit të veprimeve, sipas fushës së veprimtarisë së institucionit dhe të institucioneve të varësisë;

ç) të marrin masa për të garantuar informimin e publikut dhe për drejtimin e veprimtarive për ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të qytetarëve;

d) të sigurojnë bashkëpunim përfshirës dhe transparent me përfaqësues të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit.

6. Vendimi nr.470, datë 6.10.1999 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e Komisionit Qeveritar të Luftës kundër Korrupsionit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha